



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:012061

Datë: 10.06.2024

Numri i dokumentit: 05799002

KF.nr.404/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULI, dhe me zyrtaren ligjore Amire Jahiri në kontestin tregtar administrativ të paditësit “International Elevator Company” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlera e kontestit 12,000.00 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në mungesë të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 17.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “International Elevator Company” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI vendimi nr.400/2020, i datës 18.12.2020, i Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “International Elevator Company” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 22.01.2021, ka iniciuar kontestin tregtar - administrativ kundër vendimit nr.400/2020 i datës 18.12.2020 të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke propozuar gjykatës që të i rimburohet vlera a parimburusuar e TVSH-së. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor nuk ka prezantuar askush për paditësin edhe pse i njëjti për këtë seancë, ftesën e ka pranuar me datë 11.04.2024, ndërsa mungesën-mospjesëmarrjen nuk e ka arsyetuar. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 31.01.2024, thekson se si palë e paditur në këtë konflikt administrativ, i kundërshton në tërësi pretendimet e paraqitura në padi, si të pa bazuara në ligj dhe fakte materiale. Tutja ka cekur se ATK duke vepruar drejtë në bazë të ligjit dhe në bazë të dokumentacionit të ofruar nga paditësi, me ri kontroll konstaton se paditësi mbetet obligues i tatimit shtesë të dalë me ri kontrole, pra tatimpaguesi nuk ka arritur të dëshmojë të kundërtën e vlerësimit tatimor me prova materiale as gjatë procedurës së ankesës, bazuar në paragrafin 6 të nenit 19 të Ligjit nr.03/L-222 e cila dispozitë ligjore parasheh *“Tatimpaguesi ka barrën e provës lidhur për të provuarit se kryerja e ndonjë vlerësimi nga Drejtori i Përgjithshëm është e gabuar dhe barrën për të provuar se shuma e ndonjë vlerësimi të tillë është e pasaktë”*, tatimpaguesi përveç pretendimeve të cekura në ankesën me shkrim nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar të kundërtën. Gjykata ka shqyrtuar këtë kontest tregtar - administrativ konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së, në mungesë të palës së paditur ngase e paditur e ka pranuar ftesën për këtë seancë me datë 16.04.2024, ndërsa me parashtesën e datës 29.04.2024 e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantojë në këtë seancë duke kërkuar nga gjykata që të veprojë në pajtim me nenin 38 paragrafi 5 të LKA-së. Gjithashtu ka kërkuar që të refuzohet padi/ankesa e paditësit në tërësi si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi nr.400/2020 i datës 18.12.2020. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 17.05.2024, ka administruar provat dhe atë: vendimi 400/2020 i datës 18.12.2020, ankesa e ushtruar në ATK e datës 21.01.2021, faturat nr.01/18, 15/17, 24/19, 11/20, kontratat e datës 08.08.2017, 10.01.2020, 13.06.2019, 14.05.2017, përgjigja në padi e datës 31.01.2024 dhe raporti i kontrollit nr.1200/29.09.2020.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar - administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar - administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ, deklarimeve në padi, shkresat e lëndë aktvendimit kontestues .Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se paditësi pas pranimit të Raportit të kontrollit ka parashtruar ankesë, pran Departamentit të Ankesave të

Administratës Tatimore të Kosovës me datë 04.11.2020, për të cilën ankesë ATK me datë 18.12.2020 ka sjell vendimin nr.400/2020, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin vendim ka refuzuar si të pa bazuar ankesën nr.400/2020, ndërsa njoftim rivlerësimet e tatimit shtesë i ka vërtetuar si të bazuara, e kundër të cilit akt paditësi me këtë padi, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti Administrativ -Divizioni Fiskal.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Divizioni i Ankesave - të ATK-së, me vendimin kontestues 400/2020 të datës 18.12.2020 e ka refuzuar ankesën nr.400/2020 të datës 04.11.2020 të paditurit, ndërsa njoftim rivlerësimet e tatimit shtesë i ka vërtetuar si të bazuara, me arsyetim se Vlerësimi i kontrollit për tatim shtesë është bërë bazuar në provat materiale të dorëzuara nga tatimpaguesi, respektivisht librat dhe regjistrimet përkatëse të tatimpaguesit bazuar në nenin 19, Paragrafin 2, nën paragrafin 2.1 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, nenin 29 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010 për Zbatimin e Ligjit nr.03/L-222. Tutje ka theksuar se Divizioni i Ankesës pas analizimit të vlerësimet të kontrollës sa i përket mos pranimit të TVSH-së së zbritshëm për blerjet/importet e periudhave tatimore TVSH 01 dhe 02/2018 nën arsyetimin e kontrollit se tatimpaguesi nuk ka regjistruar, respektivisht deklaruar Importin me nr.1180 datës 27.01.2018 në vlerë prej 1, 112.52 Euro, dhe Importin me nr.2130 datës 05.02.2018 në vlerë prej 58,386.401 Euro, me të drejtë kontrolli ka vendosur se tatimpaguesi nuk ka vetë vlerësuar drejtë sipas nenit 18 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Gjykata vlerëson si të pa bazuar pretendimin e paditësit se është vërejtur një lëshim lidhur me importin me nr.1180 me datë 27.10.2018 në vlerë prej 1,112.52 dhe importi me nr.2130 me datën 05.02.2018 në vlerë 58,386.40, për arsye se nuk kemi të bëjmë me një lëshim sepse përderisa në librat dhe regjistrimet tatimpaguesi nuk ka deklaruar Importin e tij, çka edhe nuk e ka kontestuar as me ankesën e tij, vlerësimi i kontrollit për mos pranimin e TVSH-së së zbritshëm sipas nenit 38, paragrafi 2 i Ligjit nr.05/L-037 për TVSH është bazuar në dispozitën ligjore, respektivisht, kontrolli me të drejtë këto blerje/importet i ka trajtuar si blerje me TVSH të pazbritshme sipas nenit 57, paragrafi 4, nën paragrafi 4.1 i Udhëzimit Administrativ nr.03/2015 për zbatimin e Ligjit nr.05/L-037 për TVSH përderisa tatimpaguesi e ka humb të drejtën e zbritjes së TVSH-së.

Sa i përket pretendimit të paditësit në lidhje me trajtimin e transaksioneve në shitje si furnizim që i nënshtrohet ngarkesës së kundërt të TVSH-së nën arsyetimin e kontratave me Kawa Group”,

gjykata pranon si të drejtë vlerësimin e ATK-së, ku ka theksuar se në mungesë të faturës tatimore, transaksioni duhet të trajtohet si furnizim i tatueshëm është i mbështetur në dispozitat ligjore respektivisht tatimpaguesi bazuar në nenin 52, paragrafi 1 nën paragrafi 1.4.1 të Ligjit nr.05/L-037 për TVSH, respektivisht nenin 70, paragrafi 6 i Udhëzimit administrativ nr.03/2015 për Zbatimin e Ligjit nr.05/L-037 për TVSH e cila dispozitë parasheh “Faturimi: edhe pse furnizuesi nuk i obliguar të paguaj TVSH-në, ai është i obliguar të lëshoj faturë tatimore. Furnizuesi duhet të cek në faturë se klienti është i obliguar të paguaj TVSH-në duke e vendosur aty referencën e neni 52, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 të Ligji apo ndonjë referencë që tregon se furnizimi do ti nënshtrohet procedurës së ngarkesës së kundërt. Andaj konform Ligjit për TVSH në Kosovë nenit 52 nën paragrafi 1.4 “Ngarkesa e kundërt”, ka qenë i obliguar të lëshoj fatura tatimore në mënyrë të pala tjerë “Kawa Group” (investitori) të evidentoj transaksionet nën rregullat e ngarkesës së kundërt respektivisht të paguaj TVSH-në për këto transaksione.

Duke marrë për bazë faktin se gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar - administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative në vështrim të nenit 43 paragrafi 1, të LKA-se, nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga ana e organit të paditur, kjo për faktin se paditësi në këtë kontest tregtar-administrativ ka dështuar që të prezantojë provat me të cilat do të mbështet pretendimet e tija në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para Gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë. Gjykata konstaton se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj pretendimet e paditësit nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organit të paditur. Prandaj, mbi këtë gjendje të fakteve, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se paditësi as në këtë kontest tregtar-administrativ nuk ka arritur që të paraqes fakte mbi të cilat e mbështet kërkesën e tij, ngase me nenin 7.1 të LPK-së, përcaktohet se “*Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*”. Ndërsa me nenin 319.1 të LPK-së përcaktohet se “*Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*”. Andaj, pranë një gjendje të tillë faktike gjykata vlerëson se vendimi

nr.400/2020, i datës 18.12.2020 i të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës-Divizioni i Ankesave, me të cilin është refuzuar si e pa bazuar ankesa e subjektit në procedurë, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të neni 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.404/22 datë 17.05.2024

Zyrtare Ligjore
Amire JAHIRI

Gj y q t a r i
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.